



Demokracia në Veprim
Demokratija na Delu
Democracy in Action

MONITORIMI I MEDIAVE SOCIALE GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE

Zgjedhjet e parakohshme
për Kuvendin e Kosovës

7 QERSHOR, 2026

DEMOKRACIA NË VEPRIM



Përgatitur nga: Demokraci për zhvillim (D4D), në kuadër të misionit vendor për vëzhgimin e zgjedhjeve “Demokracia në Veprim”

Të drejtat e autorit ©2026. Demokraci për zhvillim (D4D) & Demokracia në Veprim (DnV).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç citimeve të pjesëve të shkurtra me qëllim të kritikës dhe rishikimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të rikthimit të të dhënave, ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjeti, elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistrues ose tjetër, pa lejen paraprake të D4D/DnV.

TABELA E PËRMBAJTJES

GJETJET KRYESORE.....	4
HYRJE	5
METODOLOGJIA E MONITORIMIT.....	6
GJETJET KRYESORE.....	7
Të përgjithshme	7
SULMET NDAJ GRAVE KANDIDATE	13
GJUHA E URREJTJES NË PORTALET ONLINE	14
Gratë candidate dhe gjuha e urrejtjes.....	14
Gjuha e urrejtjes ndaj kandidatëve për kryeministër.....	15
Gjuha e urrejtjes ndaj partive politike	16
Analiza e fjalëve më të përdorura në komentet e publikut	17
PËRFUNDIMET	18
REKOMANDIMET	19
SHTOJCA 1: FJALORTH I SHPREHJEVE KRYESORE	20

GJETJET KRYESORE

423 SHKELJE

RRJETET
SOCIALE NË TË
CILAT JANË BËRË
MË SË SHUMTI
SHKELJE:


Facebook
376


Tik Tok
47

NATYRA E SHKELJEVE TË RAPORTUARA



299
Gjuhë e urrejtjes



117
Gjuhë shpifëse/
përçmuese

4
Dezinformim
2
Keqinformim

1
Meme

LLOJI I PËRMBAJTËS PËRMES SË CILËT JANË POSTUAR SHKELJET



406
Koment

8
Postim i
shkruar

7
Video

2
Postim
dhe foto

PALËT MË TË SHËNJESTRUARA



413
Kandidat individual

9
Parti
politike

1
Tjetër

PALËT MË TË SHËNJESTRUARA

314 VV **25** PDK **20** LDK **4**
37 PSD **22** AAK **1** NDS **TJERA**

HYRJE

Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, të mbajtura më 7 qershor 2026, u zhvilluan në një periudhë politike të ngarkuar, të karakterizuar nga përplasje të vazhdueshme politike, debat i polarizuar publik dhe intensifikim i komunikimit digjital. Fushata zgjedhore ishte relativisht e shkurtër, çka e përqendroi aktivitetin politik dhe komunikimin e subjekteve zgjedhore në një periudhë të kufizuar kohore, veçanërisht në platformat e rrjeteve sociale dhe mediat online.

Në këtë kontekst, rrjetet sociale dhe mediat online vazhdojnë të luajnë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në komunikimin politik, informimin e qytetarëve dhe formësimin e debatit publik. Platformat digjitale janë shndërruar në një nga mjetet kryesore të fushatës zgjedhore, duke u mundësuar partive politike dhe kandidatëve të komunikojnë drejtpërdrejt me votuesit. Megjithatë, ato njëkohësisht krijojnë hapësirë për përhapjen e gjuhës së urrejtjes, sulmeve personale, dezinformimit dhe formave të tjera të komunikimit që mund të cenojnë cilësinë e debatit publik dhe integritetin e procesit zgjedhor.

Për të vlerësuar cilësinë e komunikimit politik online gjatë fushatës zgjedhore, Demokraci për Zhvillim (D4D), si anëtare e koalicionit Demokracia në Veprim (DnV), ka monitoruar aktivitetin e subjekteve politike, kandidatëve për kryeministër dhe kandidatëve për deputetë në rrjetet sociale, si dhe komentet dhe reagimet e publikut ndaj përmbajtjeve të publikuara. Monitorimi është fokusuar në identifikimin e rasteve të gjuhës së urrejtjes, gjuhës shpifëse dhe përçmuese, dezinformimit, keqinformimit dhe formave të tjera të komunikimit problematik që mund të ndikojnë negativisht në debatin demokratik.

Raporti nuk synon të ofrojë një vlerësim përfundimtar ligjor për secilin rast të evidentuar. Përkundrazi, ai synon të dokumentojë dhe analizojë modelet e komunikimit problematik në hapësirën online, duke identifikuar prirjet, narrativat dhe format e shprehjes që mund të ndikojnë në cilësinë e diskursit publik gjatë procesit zgjedhor.

Gjetjet e raportit tregojnë se, në kuadër të rasteve të komunikimit problematik gjatë fushatës, dominojnë gjuha e urrejtjes dhe gjuha shpifëse e përçmuese, të cilat përbëjnë pothuajse të gjitha shkeljet e evidentuara. Në të njëjtën kohë, monitorimi ka identifikuar një nivel të lartë të sulmeve personale ndaj kandidatëve individualë, si dhe një përqendrim të konsiderueshëm të rasteve në ditët e fundit të fushatës, kur aktiviteti politik online arrin intensitetin më të lartë.

Përveç monitorimit të rrjeteve sociale, raporti përfshin edhe analizën e gjuhës së urrejtjes në portalet online përmes platformës Pikasa, duke ofruar një pasqyrë më të gjerë të mënyrës se si zhvillohet debati publik në hapësirën digjitale gjatë proceseve zgjedhore. Vëmendje e veçantë i është kushtuar ndikimit të gjuhës së urrejtjes ndaj grave kandidate, kandidatëve për kryeministër dhe partive politike, si dhe identifikimit të narrativave dhe termave më të përdorur në komentet e publikut.



Ky raport synon të kontribujë në forcimin e integritetit të proceseve zgjedhore, promovimin e standardeve të komunikimit demokratik dhe ngritjen e vetëdijes për ndikimin që gjuha e urrejtjes dhe format e tjera të komunikimit problematik mund të kenë në pjesëmarrjen politike, debatin publik dhe besimin e qytetarëve në proceset demokratike.

METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Monitorimi i fushatës zgjedhore në mjedisin online është realizuar përmes vëzhgimit sistematik dhe të përditshëm të aktiviteteve të subjekteve politike dhe kandidatëve në platformat digjitale. Procesi i monitorimit ka përfshirë:

- Faqet zyrtare të subjekteve politike, ku publikohen deklarata, programe, premtime zgjedhore dhe qëndrime politike;
- Faqet zyrtare të kandidatëve për kryeministër, të cilat shërbejnë si kanale kryesore të komunikimit me qytetarët dhe promovimit të platformave politike;
- Faqet dhe profilet zyrtare të kandidatëve për deputetë, duke përfshirë postimet, videot dhe ndërveprimet me publikun.

Monitorimi është shtrirë në rrjetet sociale Facebook, Instagram dhe TikTok, të cilat përbëjnë platformat kryesore të komunikimit politik gjatë fushatës zgjedhore. Në kuadër të monitorimit janë përfshirë 21 subjekte politike dhe 902 kandidatë për deputetë.

Fokusi i monitorimit ka qenë identifikimi dhe dokumentimi i përmbajtjeve që cenojnë standardet e komunikimit demokratik dhe integritetin e procesit zgjedhor. Në veçanti janë monitoruar:

- Përdorimi i gjuhës së urrejtjes, gjuhës denigruese dhe përmbajtjeve përcmuese në postimet, videot dhe materialet promovuese të publikuara nga subjektet politike dhe kandidatët;
- Gjuha e urrejtjes, gjuha shpifëse dhe sulmet verbale të publikuara nga palët e treta, që janë përdorues të rrjeteve sociale, veçanërisht në komentet e postimeve të kandidatëve dhe subjekteve politike;
- Përmbajtjet dezinformuese dhe keqinformuese që përmbajnë informata të pavërteta ose manipuluese dhe që mund të ndikojnë në perceptimin e publikut dhe integritetin e procesit zgjedhor.

Të gjitha rastet e identifikuar janë klasifikuar sipas llojit të shkeljes, platformës ku janë publikuar, autorit të përmbajtjes, palës së shënjestruar dhe dimensionit gjinor, me qëllim të analizimit të trendeve dhe formave të komunikimit problematik gjatë fushatës zgjedhore.

Përdorimi i platformës Pikasa për analizën e të dhënave

Për të siguruar një monitorim të thelluar dhe të standardizuar, ekipi ka përdorur platformën Pikasa, një mjet analitik që mundëson mbledhjen dhe përpunimin automatik të të dhënave nga rrjetet sociale. Pikasa ka ndihmuar në:

- Identifikimin dhe klasifikimin e komenteve negative, ofenduese ose me përmbajtje të papërshtatshme.
- Matjen e ndërveprimeve (pëlqime, shpërndarje, komente) për të kuptuar përhapjen dhe ndikimin e përmbajtjeve politike.
- Kategorizimin e shkeljeve sipas llojit (gjuhë e urrejtjes, shpifje, dezinformim, keqinformim, etj.)
- Evidentimin e kandidatëve dhe partive më të shënjestruara gjatë fushatës.

Duke përdorur Pikasa, monitoruesit kanë analizuar gjithsej 86,576 artikuj të shpërndarë në Facebook, ku përfshihen postime të partive, kandidatëve dhe komentet nga përdoruesit e rrjeteve sociale.

Procesi i grumbullimit dhe analizës së të dhënave

Të gjitha të dhënat e mbledhura janë ruajtur dhe organizuar në një bazë të dhënash qendrore, duke përfshirë:

- Postimet dhe deklaratat zyrtare të partive politike dhe kandidatëve
- Komente dhe reagime nga palë të treta, duke përfshirë gjuhën e urrejtjes, shpifjet dhe dezinformimin
- Llojin e shkeljeve të identifikuar gjatë monitorimit
- Platformën ku është bërë postimi apo komenti
- Shtrirjen dhe përhapjen e përmbajtjeve, bazuar në numrin e ndërveprimeve të gjeneruara, si indikator i dukshmërisë dhe angazhimit online, por jo si matje e drejtpërdrejtë e ndikimit të tyre real në qëndrimet apo sjelljen zgjedhore të votuesve.

Pas grumbullimit të të dhënave, ekipi i monitoruesve ka kryer një analizë të thelluar për të identifikuar modelet e komunikimit, subjektet më të shënjestruara dhe ndikimin e shkeljeve në atmosferën e përgjithshme të fushatës.


GJETJET KRYESORE

Të përgjithshme

Fushata zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Kosovë u zhvillua nga data 28 maj deri më 5

qershor 2026, duke i paraprirë ditës së votimit të mbajtur më 7 qershor 2026. Monitorimi ka përfshirë 21 subjekte politike me 902 kandidatë.

Grafiku 1. Shkeljet e raportuara sipas periudhës kur kanë ndodhur



Gjatë fushatës zgjedhore 10-ditore për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, janë identifikuar gjithsej 423 shkelje në rrjetet sociale. Analiza e shpërndarjes së tyre tregon se shkeljet nuk kanë qenë të shpërndara në mënyrë të barabartë gjatë fushatës, por janë përqendruar dukshëm në fazën përmbyllëse të saj.

Në ditët e para të fushatës, numri i shkeljeve ka qenë relativisht i ulët, duke përbërë vetëm 1% deri në 7% të totalit ditor. Kjo sugjeron se aktiviteti problematik në rrjetet sociale ka qenë më i kufizuar në fillim të fushatës, kur subjektet politike kryesisht janë fokusuar në prezantimin e programeve dhe aktiviteteve elektorale.

Nga fundi i fushatës vërehet një rritje e ndjeshme e shkeljeve. Vetëm gjatë tri ditëve të fundit janë regjistruar 68% e të gjitha shkeljeve të evidentuara gjatë periudhës së monitorimit. Kjo tregon një intensifikim të konsiderueshëm të përmbajtjeve problematike në momentet vendimtare të


garës zgjedhore, kur partitë politike dhe mbështetësit e tyre përpiqen të ndikojnë tek votuesit e pavendosur dhe të mobilizojnë elektoratin.

Veçanërisht shqetësues është fakti se 42% e të gjitha shkeljeve janë evidentuar në ditën e fundit të fushatës. Ky përqendrim i lartë sugjeron se periudha menjëherë para votimit paraqet rrezikun më të madh për përhapjen e dezinformimit, gjuhës së urrejtjes, sulmeve personale dhe formave të tjera të komunikimit që cenojnë standardet demokratike të procesit zgjedhor.

Të dhënat tregojnë gjithashtu se mbi gjysma e të gjitha shkeljeve (58%) janë regjistruar në dy ditët e fundit të fushatës, duke dëshmuar se dinamika e komunikimit politik në rrjetet sociale bëhet dukshëm më agresive dhe më pak e kontrolluar sa më shumë afrohet dita e votimit.

Këto gjetje nxjerrin në pah nevojën që institucionet përgjegjëse, organizatat monitoruese dhe platformat e rrjeteve sociale të rrisin kapacitetet e monitorimit dhe reagimit në fazën përmbyllëse të fushatave zgjedhore,

Grafiku 2. Proporcioni i shkeljeve të raportuar sipas llojit të shkeljes



Analiza e llojeve të shkeljeve të identifikuar gjatë monitorimit të rrjeteve sociale tregon se diskursi problematik gjatë fushatës zgjedhore është dominuar pothuajse tërësisht nga format e komunikimit që synojnë denigrimin, sulmin dhe nxitjen e ndasive ndaj kundërshtarëve politikë.

Dominimi i gjuhës së urrejtjes

Gjuha e urrejtjes përbën 70.7% të të gjitha shkeljeve të evidentuara, duke e bërë atë kategorinë më të përhapur me një diferencë të konsiderueshme ndaj të gjitha formave të tjera të shkeljeve. Ky nivel i lartë tregon se komunikimi politik në rrjetet sociale është karakterizuar kryesisht nga përdorimi i gjuhës fyese, stigmatizuese dhe përçarëse ndaj individëve apo grupeve të caktuara. Përhapja kaq e madhe e kësaj forme të komunikimit dëshmon për një nivel të lartë polarizimi politik dhe një prirje për ta zëvendësuar debatin mbi programet dhe politikat me sulme ndaj kundërshtarëve.

Përhapja e gjuhës shpifëse dhe përçmuese

Kategoria e dytë më e shpeshtë është gjuha shpifëse dhe përçmuese, e cila përbën 27.7% të shkeljeve. E kombinuar me gjuhën e urrejtjes, këto dy kategori përfaqësojnë

pasi pikërisht në këtë periudhë ndodh pjesa dërrmuese e shkeljeve dhe rreziku për ndikim negativ në integritetin e procesit zgjedhor është më i lartë.

98.4% të të gjitha rasteve të evidentuara. Kjo tregon se shumica dërrmuese e shkeljeve lidhen me forma të komunikimit agresiv dhe degradues ndaj kundërshtarëve politikë, duke krijuar një mjedis online të karakterizuar nga konflikti, diskreditimi dhe sulmet personale.

Prani minimale e dezinformimit dhe keqinformimit

Dezinformimi përbën vetëm 0.9% të rasteve të evidentuara, ndërsa keqinformimi 0.5%. Këto përqindje relativisht të ulëta tregojnë se gjatë kësaj fushate problematika kryesore në rrjetet sociale nuk ka qenë përhapja e informacionit të rremë ose manipulues, por përdorimi i gjuhës ofenduese dhe nxitëse ndaj aktorëve politikë dhe mbështetësve të tyre.


Megjithatë, edhe pse numri i rasteve është i vogël, ndikimi potencial i dezinformimit mbetet i rëndësishëm, pasi përmbajtje të tilla mund të arrijnë audiencën të gjera dhe të ndikojnë në perceptimet e votuesve.

Përdorimi i kufizuar i memeve problematike

Memet përbëjnë vetëm 0.2% të rasteve të evidentuara. Kjo tregon se përmbajtjet satirike ose ironike me karak-

ter shkelës nuk kanë qenë një formë e rëndësishme e komunikimit problematik gjatë kësaj fushate. Ndryshe nga trendet e vërejtura në disa procese zgjedhore ndërkombëtare, ku memet përdoren gjerësisht për diskreditimin e kundërshtarëve, në rastin e Kosovës komunikimi problematik është shfaqur kryesisht përmes deklaratave të drejtpërdrejta dhe jo përmes përmbajtjeve humoristike apo satirike.

Grafiku 3. Proporcioni i shkeljeve sipas rrjeteve sociale



Përfundimi

Struktura e shkeljeve tregon se problematika kryesore e komunikimit zgjedhor në rrjetet sociale gjatë kësaj fushate nuk ka qenë manipulimi i informacionit, por degradimi i cilësisë së debatit publik përmes gjuhës së urrejtjes dhe gjuhës shpifëse e përçmuese. Fakti që këto dy kategori përbëjnë pothuajse të gjitha shkeljet e evidentuara dëshmon se diskursi politik online ka qenë i dominuar nga sulmet personale dhe retorika përçarëse, duke lënë në plan të dytë debatin për programet, politikat dhe çështjet me interes publik.

Analiza e platformave ku janë evidentuar shkeljet tregon se Facebook ka qenë hapësira kryesore ku është zhvilluar komunikimi problematik gjatë fushatës zgjedhore. Nga

gjithsej shkeljet e identifikuar, 89% janë regjistruar në Facebook, ndërsa vetëm 11% në TikTok.


Ky dominim i Facebook-ut lidhet me përdorimin më të gjerë të kësaj platforme nga partitë politike, kandidatët, aktivistët dhe mbështetësit e tyre për komunikim politik dhe fushatë elektorale. Të dhënat tregojnë se Facebook mbetet rrjeti social me ndikimin më të madh në debatin

politik online në Kosovë, por njëkohësisht edhe platforma ku paraqitet pjesa dërrmuese e shkeljeve.

Megjithëse TikTok ka një peshë dukshëm më të vogël në numrin e shkeljeve të evidentuara, prania e rasteve edhe në këtë platformë tregon zgjerimin gradual të komunikimit politik drejt rrjeteve sociale të orientuara kryesisht te audiencat më të reja.

Në përgjithësi, shpërndarja e shkeljeve sipas platformave dëshmon se monitorimi dhe adresimi i përmbajtjeve problematike duhet të fokusohet kryesisht në Facebook, ku është evidentuar pothuajse e gjithë veprimtaria që bie ndesh me standardet e komunikimit demokratik gjatë fushatës zgjedhore.

Grafiku 4. Lloji i përmbajtjes përmes së cilët janë postuar shkeljet



Analiza e llojit të përmbajtjes përmes së cilës janë publikuar shkeljet tregon se komentet kanë qenë forma dominuese e komunikimit problematik gjatë fushatës zgjedhore, duke përbërë 96% të të gjitha rasteve të evidentuara. Ky rezultat tregon se pjesa më e madhe e shkel

jeve nuk ka ardhur nga komunikimi zyrtar i subjekteve politike, por nga ndërveprimet e përdoruesve në seksionet e komenteve, ku kontrolli dhe moderimi i përmbajtjes është më i kufizuar.


Format e tjera të publikimit kanë pasur një peshë shumë më të vogël. Postimet e shkruara përbëjnë 1.9% të rasteve, ndërsa videot 1.7%. Postimet e shoqëruara me fotografi përfaqësojnë vetëm 0.5% të shkeljeve të evidentuara.

Këto të dhëna nxjerrin në pah se komunikimi problematik gjatë fushatës është zhvilluar kryesisht në hapësirat e diskutimit dhe reagimit të përdoruesve, më shumë sesa përmes përmbajtjeve të publikuara drejtpërdrejt nga faqet, kandidatët apo subjektet politike. Për rrjedhojë, komentet paraqesin një nga sfidat kryesore për monitorimin dhe adresimin e gjuhës së urrejtjes dhe formave të tjera

të komunikimit që cenojnë standardet e debatit demokratik online.

Megjithatë, kjo nuk i përjashton kandidatët dhe subjektet politike nga përgjegjësia për tonin dhe cilësinë e debatit që zhvillohet në hapësirat e tyre digjitale. Përmes mënyrës së komunikimit, narrativave që promovojnë dhe praktikave të moderimit të faqeve të tyre, ata mund të ndikojnë në krijimin ose përforcimin e një mjedisi komunikimi më të polarizuar. Mungesa e reagimit, mosmoderimi ose moslargimi i komenteve problematike mund të kontribuojë në normalizimin e gjuhës së urrejtjes, sulmeve personale dhe formave të tjera të papranueshme të komunikimit online.

Grafiku 5. Palët më të shënjestruara



Analiza e palëve të shënjestruara nga përmbajtjet që përbëjnë shkelje tregon se kandidatët individualë kanë qenë objektivi kryesor i sulmeve dhe komunikimit problematik gjatë fushatës zgjedhore. Nga të gjitha rastet e evidentuara, 97.6% kanë pasur në shënjestër kandidatë individualë, ndërsa vetëm 2.1% janë drejtuar ndaj partive politike dhe 0.2% ndaj kategorive të tjera.


Ky dominim i sulmeve ndaj individëve tregon se debati online gjatë fushatës është përqendruar kryesisht te personalizimi i garës zgjedhore, ku fokusi ka qenë te figurat politike dhe jo te programet apo subjektet që ato për

faqësojnë. Një qasje e tillë kontribuon në rritjen e sulmeve personale, gjuhës fyese dhe përmbajtjeve denigruese, duke e zhvendosur vëmendjen nga diskutimi i politikave publike dhe çështjeve programore.

Përqindja shumë e ulët e rasteve të drejtuara ndaj partive politike tregon se komunikimi negativ në rrjetet sociale është orientuar pothuajse tërësisht ndaj individëve, duke reflektuar një tendencë të fortë të personalizimit të debatit politik në hapësirën online gjatë kësaj fushate zgjedhore.



Grafiku 6. Partitë politike më të shënjestruara



Analiza e partive politike të shënjestruara tregon se Lëvizja Vetëvendosje (VV) ka qenë objektivi kryesor i përmbytjeve që përbëjnë shkelje, duke qenë subjekt i 74.2% të rasteve të evidentuara. Kjo përqindje është dukshëm më e lartë se ajo e çdo partie tjetër dhe mund të lidhet me pozitën e saj si forca më e madhe politike dhe subjekti kryesor në garën zgjedhore, çka e bën më të ekspozuar ndaj kritikave, sulmeve dhe komunikimit negativ në rrjetet sociale.

Pas VV-së, më të shënjestruarat kanë qenë PSD me 8.7%, PDK me 5.9%, AAK me 5.2% dhe LDK me 4.7% të rasteve. Dallimi i madh ndërmjet VV-së dhe partive të tjera tregon se komunikimi problematik është përqendruar kryesisht ndaj një subjekti të vetëm politik.

Kjo shpërndarje pasqyron një nivel të lartë të polarizimit politik në rrjetet sociale, ku pjesa më e madhe e sulmeve dhe përmbytjeve problematike është fokusuar ndaj partisë që ka dominuar skenën politike dhe garën zgjedhore. Në të njëjtën kohë, fakti që edhe partitë e tjera kanë qenë objekt i shkeljeve tregon se komunikimi negativ ka prekur pothuajse të gjithë spektrin politik, megjithëse në përmasa dukshëm më të vogla.

SULMET NDAJ GARAVE KANDIDATE



Analiza e rasteve të shënjestrimit ndaj grave kandidate, tregon se gratë kanë qenë objekt i



në rrjetet sociale, duke përbërë një pjesë të konsiderueshme të përmbytjeve problematike të evidentuara gjatë fushatës zgjedhore. Ky nivel i lartë i sulmeve ndaj grave tregon se gratë që marrin pjesë në jetën politike dhe publike vazhdojnë të përballen me ekspozim disproporcional ndaj gjuhës fyese, denigruese dhe formave të tjera të dhunës online.



55.6%

Palë të treta



44.4%

Kandidatë të partive politike

Sa i përket autorëve të këtyre sulmeve, 55.6% e rasteve janë kryer nga palë të treta, ndërsa 44.4% nga kandidatë të partive politike. Kjo shpërndarje tregon se sulmet ndaj grave nuk burojnë vetëm nga aktet politikë, por në një masë edhe më të madhe nga mbështetës, aktivistë apo përdorues të tjerë të rrjeteve sociale që nuk përfaqësojnë zyrtarisht subjekte politike.



Të dhënat nxjerrin në pah se dhuna dhe sulmet online ndaj grave mbeten një sfidë serioze për pjesëmarrjen e barabartë në politikë. Fakti që mbi gjysma e sulmeve vijnë nga palë të treta tregon se adresimi i kësaj dukurie kërkon jo vetëm përgjegjësi më të madhe nga subjektet politike, por edhe mekanizma më efektivë për monitorimin dhe moderimin e përmbytjeve problematike në rrjetet sociale.

Kandidatët Komentet me Gjuhë e urrejtjes Komente Postime

gjuhë të urrejtjes %

GJUHA E URREJTJES NË PORTALET ONLINE

Monitorimi i 152 portaleve në gjuhën shqipe dhe serbe përmes platformës Pikasa gjatë periudhës 28 maj - 5 qershor 2026 evidentoi një nivel të konsiderueshëm të gjuhës së urrejtjes në hapësirat online. Nga mbi 334,570 komente të analizuara, 22,091 komente janë identifikuar si përmbajtje që përmbajnë gjuhë të urrejtjes – që përbëjnë 7% të totalit.

Niveli prej 7% tregon se gjuha e urrejtjes nuk përfaqëson një dukuri marginale në diskutimet online të lidhura me zgjedhjet, por është e pranishme në një pjesë të konsiderueshme të debatit publik. Duke pasur parasysh volumin e lartë të komenteve, numri i rasteve të evidentuara dëshmon se platformat online vazhdojnë të shërbejnë si hapësira ku shpesh manifestohen polarizimi politik, sulmet verbale dhe format e tjera të komunikimit përçarës.


Gratë kandidate dhe gjuha e urrejtjes

Të dhënat tregojnë se gratë kandidate kanë qenë veçanërisht të ekspozuara ndaj gjuhës së urrejtjes gjatë fushatës zgjedhore. Nga 39,866 komente të analizuara që lidhen me gratë kandidate, 3,062 janë identifikuar si komente që përmbajnë gjuhë të urrejtjes, ose 8% e totalit.

Fakti që përqindja e gjuhës së urrejtjes ndaj grave kandidate është më e lartë se mesatarja e evidentuar në portal-et online në përgjithësi (8% kundrejt 7%) tregon se gratë në politikë përballen me një nivel më të lartë të komunikimit negativ dhe denigrues. Kjo pasqyron sfidat shtesë me të cilat përballen gratë në jetën publike dhe politike, ku shpesh bëhen objekt i sulmeve personale që tejkalojnë debatin politik apo programor.


Ndër gratë më të shënjestruara, Doarsa Kica-Xhelili Fitore Pacolli-Dalipi, Arbëreshë Kryeziu-Hyseni dhe Ganimete Musliu, që kanë regjistruar përqindjet më të larta të komenteve me gjuhë të urrejtjes, të cilat variojnë nga 9% deri në 15% të komenteve të analizuara për secilën prej tyre individualisht. Këto nivele janë dukshëm mbi mesataren e përgjithshme të monitorimit dhe tregojnë se figurat më të ekspozuara politikisht janë gjithashtu më të cenueshme ndaj sulmeve verbale në hapësirën online.

Në tërësi, gjetjet konfirmojnë se gjuha e urrejtjes mbetet një sfidë serioze për cilësinë e debatit publik dhe se gratë kandidate vazhdojnë të përballen me forma disproporcionale të sulmeve online. Këto sulme mund të krijojnë efekt dekurajues për pjesëmarrjen e grave në jetën politike dhe të paraqesin pengesë potenciale për përfaqësimin e tyre të barabartë në proceset demokratike.



Gjuha e urrejtjes ndaj kandidatëve për kryeministër

Analiza e komenteve në portalet online tregon dallime të konsiderueshme në nivelin e gjuhës së urrejtjes të drejtuar ndaj kandidatëve për kryeministër gjatë fushatës zgjedhore.




Albin Kurti ka qenë kandidati më i ekspozuar si në numrin e artikujve ashtu edhe në vëllimin e komenteve. Ai është përmendur në 804 artikuj, ku janë regjistruar mbi 74 mijë komente, prej të cilave 8% përmbanin gjuhë të urrejtjes. Përveç përqindjes relativisht të lartë, ai ka regjistruar edhe numrin më të madh absolut të komenteve me gjuhë të urrejtjes, çka lidhet me ekspozimin e tij dukshëm më të madh në debatet publike dhe mediatike gjatë fushatës.


Lumir Abdixhiku ka regjistruar nivelin e dytë më të lartë të gjuhës së urrejtjes, me 7% të komenteve të identifikuar si problematike. Edhe pse vëllimi i përgjithshëm i komenteve ka qenë dukshëm më i ulët krahasuar me kandidatët e tjerë, përqindja e lartë tregon se diskutimet rreth tij kanë qenë relativisht më të polarizuara.

Nga ana tjetër, Bedri Hamza dhe Ardian Gjini kanë regjistruar nivele relativisht më të ulëta të gjuhës së urrejtjes, me nga 4% të komenteve të klasifikuara si të tilla. Këto përqindje janë dukshëm nën nivelin e evidentuar për kandidatët Albin Kurti dhe Lumir Abdixhiku, duke sugjeruar një intensitet më të ulët të komunikimit urrejtës në përmbytjet që lidhen me këta kandidatë.

Në përgjithësi, të dhënat tregojnë se kandidatët me ekspozimin më të madh publik dhe mediatik kanë qenë më të prirur të përballen me nivele më të larta të gjuhës së urrejtjes. Gjithashtu, fakti që përqindja e komenteve me gjuhë të urrejtjes varion nga 4% deri në 8% tregon se komunikimi negativ ka qenë i pranishëm ndaj të gjithë kandidatëve kryesorë, ndonëse me intensitet të ndryshëm. Kjo pasqyron nivelin e lartë të polarizimit politik në diskutimet online gjatë fushatës zgjedhore.



Gjuha e urrejtjes ndaj partive politike



Analiza e komenteve në portalet online tregon se numri i komenteve me gjuhë të urrejtjes ndaj partive politike ka ndryshuar ndjeshëm nga një subjekt në tjetrin. Rënditja e partive më të ekspozuara është bërë mbi bazën e numrit absolut të komenteve të identifikuar me gjuhë të urrejtjes, pasi përqindjet mund të rezultojnë më të larta te subjektet që kanë pasur volum më të ulët të komenteve.

Përqindja e komenteve me gjuhë të urrejtjes mbetet një tregues plotësues për të vlerësuar intensitetin proporcional të komunikimit urrejtës ndaj secilit subjekt politik. Në këtë aspekt, Lista Serbe (14%), NISMA Socialdemokrate (12%), Partia FJALA (11%) dhe Partia Social Demokrate (10%) kanë pasur përqindjen më të lartë të komenteve me gjuhë të urrejtjes. Megjithatë, këto rezultate duhet të interpretohen duke marrë parasysh volumin e përgjithshëm të komenteve për secilën parti.

Ndër partitë kryesore parlamentare, Lëvizja Vetëvendosje ka regjistruar nivelin më të lartë të gjuhës së urrejtjes me 7%, e ndjekur nga PDK me 6%, AAK me 4% dhe LDK me 3%. Edhe pse përqindjet e tyre janë më të ulëta krahasuar me disa subjekte më të vogla, këto parti kanë gjeneruar num-

rin më të madh të komenteve dhe për rrjedhojë edhe numrin më të madh absolut të rasteve me gjuhë të urrejtjes.

Veçanërisht, Lëvizja Vetëvendosje ka regjistruar numrin më të lartë të komenteve me gjuhë të urrejtjes, e ndjekur nga PDK, PSD dhe LDK. Kjo lidhet me ekspozimin më të madh publik dhe mediatik të këtyre partive gjatë fushatës zgjedhore, si dhe me nivelin e lartë të polarizimit politik që karakterizon debatin online rreth tyre.

Në përgjithësi, të dhënat tregojnë se gjuha e urrejtjes ka prekur të gjithë spektrin politik, por me intensitet të ndryshëm. Ndërsa partitë më të vogla kanë regjistruar përqindje më të larta të komenteve problematike, partitë më të mëdha kanë qenë objekt i numrit më të madh të rasteve për shkak të vëmendjes dhe angazhimit më të lartë të publikut në përmbytjet që lidhen me to. Kjo pasqyron nivelin e lartë të polarizimit dhe antagonizmit politik në diskutimet online gjatë fushatës zgjedhore.

Analiza e fjalëve më të përdorura në komentet e publikut



Analiza e fjalëve më të përdorura në komentet e publikut tregon se diskursi online gjatë fushatës zgjedhore është karakterizuar nga përdorimi i shpeshtë i gjuhës fyese, denigruese dhe stigmatizuese. Prania e shpeshtë e këtyre termave tregon se një pjesë e konsiderueshme e debatit politik online është zhvilluar përmes sulmeve personale dhe etiketimeve negative ndaj kandidatëve, duke lënë në plan të dytë diskutimin për programet, politikat dhe çështjet me interes publik. Veçanërisht, përdorimi i fjalëve si “tradhtar”, “kriminel” dhe “analfabet” reflekton një tendencë për delegjitimimin e aktorëve politikë përmes akuza-ve dhe diskreditimit personal.


Po ashtu, identifikimi i termave me përmbajtje vulgare dhe nënçmuese tregon një nivel të ulët të kulturës së debatit në hapësirat online dhe një shkallë të lartë të polarizimit politik. Kjo gjuhë jo vetëm që cenon standardet e komunikimit demokratik, por gjithashtu kontribuon në krijimin e një mjedisi armiqësor dhe përcarës për pjesëmarrësit në jetën politike dhe publike.

Në përgjithësi, analiza e fjalëve më të përdorura konfirmon gjetjet e monitorimit se gjuha e urrejtjes dhe komunikimi denigrues kanë qenë ndër format dominuese të ndërveprimit në komentet e publikut gjatë fushatës zgjedhore.

PÄRFUNDIMET

Monitorimi i fushatës zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës të mbajtura më 7 qershor 2026 tregon se rrjetet sociale dhe mediat online kanë vazhduar të luajnë një rol qendror në komunikimin politik dhe debatet publike gjatë periudhës zgjedhore. Megjithatë, gjetjet e monitorimit dëshmojnë se hapësira digjitale është shoqëruar edhe me një nivel të konsiderueshëm të komunikimit problematik, i cili në shumë raste ka cenuar standardet e debatit demokratik.

Analiza e rasteve të evidentuara tregon se gjuha e ur-rejtjes dhe gjuha shpifëse e përçmuese kanë dominuar pothuajse tërësisht spektrin e shkëlqeve të identifikuar. Kjo dëshmon se komunikimi politik online gjatë fushatës është karakterizuar në masë të madhe nga sulmet personale, etiketimet negative dhe retorika përçarëse, ndërsa debati për programet, politikat publike dhe çështjet me interes për qytetarët ka mbetur në plan të dytë.



Monitorimi i fushatës zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës të mbajtura më 7 qershor 2026 tregon se rrjetet sociale dhe mediat online kanë vazhduar të luajnë një rol qendror në komunikimin politik dhe debatet publike gjatë periudhës zgjedhore.

Raporti evidenton gjithashtu një personalizim të theksuar të sulmeve, pasi pothuajse të gjitha shkeljet kanë pasur në shënjestër kandidatë individualë dhe jo subjektet politike. Kjo tregon se gara zgjedhore në hapësirën online është zhvilluar kryesisht përmes sulmeve ndaj figurave politike, duke nxitur polarizimin dhe antagonizmin ndërmjet mbështetësve të subjekteve të ndryshme.

Një gjetje tjetër me rëndësi është përqendrimi i shkeljeve në fazën përmbyllëse të fushatës. Rritja e ndjeshme e rasteve në ditët e fundit tregon se komunikimi online bëhet më agresiv dhe më pak i kontrolluar sa më shumë afrohet dita e votimit. Kjo periudhë paraqet rrezikun më të madh për përhapjen e përmbytjeve që mund të ndikojnë negativisht në cilësinë e debatit publik dhe në integritetin e procesit zgjedhor.

Monitorimi i portaleve online konfirmon se gjuha e urrejtjes mbetet e pranishme në një pjesë të konsiderueshme të komenteve të publikut. Veçanërisht shqetësues mbetet niveli i lartë i gjuhës së urrejtjes ndaj grave kandidatë, të cilat janë përballur me një shkallë më të lartë të sulmeve krahasuar me mesataren e përgjithshme të monitorimit. Kjo tregon se gratë në politikë vazhdojnë të përballen me barriera shtesë në pjesëmarrjen e tyre në jetën publike dhe politike.

Në përgjithësi, gjetjet e këtij raporti dëshmojnë se sfida kryesore e komunikimit zgjedhor online në Kosovë nuk lidhet me dezinformimin, por me normalizimin e gjuhës së urrejtjes, fyerjeve dhe komunikimit denigrues. Përmirësimi i cilësisë së debatit publik kërkon angazhim më të madh nga subjektet politike, institucionet përgjegjëse, mediat, platformat digjitale dhe vetë përdoruesit e rrjeteve sociale për të promovuar një kulturë komunikimi të bazuar në respekt, argumentim dhe konkurrencë demokratike.

REKOMANDIMET

Duke u bazuar në gjetjet e monitorimit, veçanërisht dominimin e komenteve problematike, përqendrimin e rasteve në fund të fushatës dhe ekspozimin më të lartë të grave kandidate ndaj gjuhës së urrejtjes, rekomandohen masat në vijim:



Për subjektet politike dhe kandidatët

- Të miratojnë dhe zbatojnë rregulla të brendshme për komunikim etik online, duke ndaluar gjuhën e urrejtjes, sulmet personale dhe gjuhën denigruese nga kandidatët, aktivistët dhe përfaqësuesit e tyre.
- Të forcojnë moderimin e faqeve dhe profileve zyrtare, përfshirë largimin ose raportimin e komenteve që përmbajnë gjuhë të urrejtjes, kërcënime, sulme gjinore apo përmbajtje të tjera problematike.
- Të reagojnë publikisht ndaj sulmeve në baza gjinore dhe të shmangin narrativat që mund të nxisin polarizim, stigmatizim ose armiqësi ndaj kundërshtarëve politikë.
- Të caktojnë persona përgjegjës për monitorimin e komunikimit online, me vëmendje të shtuar gjatë ditëve të fundit të fushatës.



Për mediat dhe portalet online

- Të zbatojnë politika të qarta dhe të qasshme për moderimin e komenteve, duke përcaktuar kategoritë e përmbajtjeve që nuk lejohen dhe procedurat për largimin e tyre.
- Të investojnë në kombinimin e filtrave automatikë me moderim njerëzor, veçanërisht për përmbajtjet që përmbajnë gjuhë të urrejtjes, sulme gjinore dhe fyerje të përsëritura.
- Të shmangin titujt, formulimet ose praktikat editoriale që mund të nxisin polarizim dhe të rrisin angazhimin përmes konfliktit.



Për trupat menaxhuese zgjedhore dhe institucionet përgjegjëse

- Të krijojnë mekanizma koordinues me mediat, platformat digjitale, organizatat monitoruese dhe institucionet kompetente për reagim më të shpejtë ndaj përmbajtjeve problematike.
- Të intensifikojnë monitorimin publik dhe komunikimin informues në ditët e fundit të fushatës, kur rreziku për përhapjen e komunikimit problematik është më i lartë.
- Të zhvillojnë udhëzime për parandalimin dhe adresimin e sulmeve online ndaj grave kandidate dhe grupeve të tjera të cenueshme.



Për monitoruesit dhe organizatat e shoqërisë civile

- Të vazhdojnë monitorimin sistematik të komunikimit online gjatë gjithë ciklit zgjedhor, me kapacitete të shtuara në periudhën para ditës së votimit.
- Të publikojnë gjetje periodike dhe të qasshme për publikun, në mënyrë që rastet dhe trendet problematike të adresohen me kohë.
- Të zhvillojnë programe për edukim mediatik dhe digjital, me fokus në njohjen e gjuhës së urrejtjes, dezinformimit dhe sulmeve gjinore online.
- Të ofrojnë mbështetje për kandidatët dhe grupet e shënjestruara, përfshirë udhëzime për raportim, dokumentim dhe reagim ndaj sulmeve në hapësirën digjitale.

SHTOJCA 1:

FJALORTH I SHPREHJEVE KRYESORE

Gjuha e urrejtjes	Fjalim ose shkrim abuziv ose kërcënues që shpreh paragjykim kategorik kundër një grupi të caktuar, veçanërisht në bazë të racës, gjinisë, fesë ose orientimit seksual.
Dezinformim	Informacione të rreme të shpërndara qëllimisht dhe shpeshherë fshehtazi (siç është nisja e thashethemeve) me qëllim që të ndikojë në opinionin publik ose të turbullojë të vërtetën .
Keqinformim	Përhapja e informacionit të gabuar ose të pavërtetë, pavarësisht nëse është bërë me qëllim apo pa qëllim.
Informacion jashtë kontekstit	Kur një pjesë e informacionit ose një deklaratë interpretohet, përdoret ose paraqitet në një mënyrë që nuk reflekton kuptimin e saj të plotë apo të saktë në kontekstin origjinal. Kjo mund të ndodhë qëllimisht ose pa dashje dhe shpesh çon në keqkuptime ose interpretime të gabuara.
Gjuhë shpifëse/ përçmuese	Çdo lloj gjuhe, qoftë e shkruar apo e folur, që ka për qëllim të ulë, të dëmtojë reputacionin, ose të denigrojë një person, grup apo institucion.
Meme	Foto, video, etj. zbavitëse ose interesante, që përhapet gjerësisht në internet.

Përkrahur nga:

